



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit: 23.9.8-2010-08

**RAPORT I AUDITIMIT
PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLET NË KOSTT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2010**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje	5
II. Opinioni i vitit të kaluar.....	6
III. Historiku	7
IV. Raportimi i jashtëm.....	8
IV.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	8
IV.2 Cilësia e informatave	9
V. Realizimi i Buxhetit	10
V.1 Të hyrat	10
V.2 Shpenzimet.....	11
VI. Kontrolli mbi menaxhimin.....	15
VI.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	15
VI.2 Auditimi i Brendshëm.....	16
VII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e KOSTT	17
Shtojca I. Komentet e KOSTT-it dhe përgjigjja e ZAP-it	18

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë në Kosovë
KRPP	Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MF	Ministria e Financave (emri i ri i MEF)
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (e re)
NP	Ndërmarrje Publike
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PF	Pasqyrat Financiare
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZRrE	Zyra Rregullative e Energjisë

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin për menaxhimin financiar dhe kontrollet brenda Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të hartuara nga INTOSAI (SNISA) duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një konkludim rreth menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Prezenca e tyre në vazhdimësi mund të zbehtë besueshmërinë ndaj menaxhimit dhe kontrolleve në KOSTT. Këto mangësi mund ta rrezikojnë kredibilitetin dhe besimin në mënyrën se si menaxhohet KOSTT.

Mangësitë janë vërejtur sidomos në raportim vjetor me kohë, menaxhimin e blerjeve nëpërmjet prokurimit, realizimin e kontratave si dhe në menaxhimin e personelit. Po ashtu trajtimi i të hyrave nga transiti dhe shpenzimet e rregullimit sekondar janë çështje që duhet rregulluar.

Kjo na shpjen në mendimin se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke siguruar menaxhim cilësor.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguron:

- Planifikim adekuat të buxhetit vjetor;
- Raporti vjetor të përgatitet e miratohet me kohë nga Bordi, dhe të dorëzohet në MEF;
- Aktivitete të prokurimit në përputhje të plotë me qëllimet e legjislacionit;
- Planifikim të mirë të projekteve dhe menaxhim të mirë të kontratave të nënshkruara; dhe
- Menaxhim të duhur të personelit.

Dobësitë e vërejtura tregojnë se sistemi i kontrollit të brendshëm ka nevojë të përmirësohet. Në lidhje me këtë ne rekomandojmë Bordin e KOSTT-it të siguroj zhvillimin e instruksioneve dhe procedurave të qarta, të cilat do të ndihmojnë adresimin e dobësive të kontrollit dhe mangësive të adresuara në këtë raport.

Menaxhmenti i KOSTT-it është pajtuar me të gjeturat dhe konkludimet tona në këtë raport, dhe është zotuar se do të bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollat në KOSTT gjatë vitit 2010.

Ndërsa për auditimin e Pasqyrave Financiare në tërësi, KOSTT-i në bazë të kërkesave ligjore ka lidhur kontratë me një firmë private të auditimit. Njëkohësisht kjo firmë kryen auditimin e llogarive të afarizmit të KOSTT-it, i cili auditim kryhet për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRE). Përfundimi i këtyre raporteve është planifikuar në Maj të vitit 2011.

Është përgjegjësi e Bordit të KOSTT-it të vendosë sistem funksional të kontrollit të brendshëm dhe të siguroj menaxhim të mirë financiar. Po ashtu KOSTT-i duhet të përgatisë pasqyrat dhe raportet financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimin financiar në bazë të parimit akrual të kontabilitetit.

Bordi po ashtu është përgjegjës për raportim lidhur me shpenzimin e Subvencionit Qeveritar. Kjo bëhet në bazë të marrëveshjes për Monitorim dhe Kontroll ndërmjet MEF-it dhe KOSTT-it.

Auditimi Menaxherial është definuar si verifikim i kontrolleve, vlerësim i menaxhimit financiar, duke përfshirë ekzaminimin e raporteve financiare si dhe vlerësimin e tyre.

Në këtë auditim ne kemi analizuar:

- Nëse janë vendosur kontrole funksionale dhe nëse ato sigurojnë menaxhim të duhur financiar;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin për kontrollet dhe menaxhimin financiar në përgjithësi.

Fillimisht ne kemi kryer auditimin e përkohshëm në KOSTT, duke trajtuar adresimin e rekomandimeve të mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Përmes memorandumit të auditimit i cili është dorëzuar në dhjetor të vitit 2010, kemi këshilluar menaxhmentin për forcimin e kontrolleve dhe adresimin e çështjeve lidhur me menaxhimin financiar.

Në këtë auditim ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat dhe raportet vjetore financiare të KOSTT-it, në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi rishikuar sistemin e kontrollit të brendshëm, rregulloret, politikat dhe vendimet e nxjerrura nga KOSTT, si dhe aplikimi i tyre gjatë menaxhimit të organizatës;

- Kemi përcaktuar nëse raportet vjetore financiare të KOSTT-it janë përgatitur në pajtim me SNK dhe kërkesat e aplikueshme;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të konkludimit tonë mbi pasqyrat dhe raportet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste të kontrolleve si dhe testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në KOSTT.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollet, dhe japim një konkludim mbi cilësinë dhe funksionimin e tyre.

II. Opinioni i vitit të kaluar

Vitin e kaluar Pasqyrat Financiare të KOSTT-it janë audituar nga kompania private e auditimit Deloitte e cila kishte dhënë *Opinion të pakualifikuar*.

Përveç auditimit vjetor të Pasqyrave Financiare, KOSTT ka obligim ndaj ZRrE-së të dorëzoj raport të veçantë të auditimit për llogaritë e afarizmit të Operatoreve të licencuar nga ZRrE-ja (Operatori i sistemit, transmissioinit dhe tregut).

Këto dy auditime për vitin 2009 janë kryer nga kompania Deloitte, e cila ka dhënë *Opinion të pakualifikuar*.

Në këto dy raporte ishte *theksuar çështja* e pronësisë së disa aseteve të KOSTT-it, pronësia e të cilave nuk ishte e zgjidhur ende.

KOSTT-i kishte bërë përpjekje të zgjidhë çështjen e pronësisë mbi pasuritë e saj, megjithatë nuk ka progres të mjaftueshëm lidhur më këtë, andaj çështja e pronësisë së pasurive është e njëjtë edhe këtë vit.

III. Historiku

KOSTT sh.a është Ndërmarrje Publike – Qendrore e organizuar si Shoqëri Aksionare.

KOSTT-i si kompani në vete, është krijuar si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë, e cila zyrtarisht është ndarë nga KEK-u në Korrik të vitit 2006.

KOSTT sh.a, është një subjekt i cili luan rol të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë. Emërimi i saj është bërë nga Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM), ndërsa në Tetor të vitit 2006 është licencuar nga ZRrE-ja, si Operator i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës.

Si Operator i Sistemit të Transmisionit (OST), KOSTT-i është përgjegjës për menaxhimin dhe funksionimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë si dhe është përgjegjës për transmisionin e energjisë elektrike të tensionit të lartë.

Si Operator i Tregut (OT) të energjisë elektrike, KOSTT-i është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtimit të energjisë si dhe për menaxhimin e procesit të vendimmarrjes përfundimtare.

KOSTT-it ende nuk ka arritur të rregulloj statusin e Rrjetit të saj dhe të menaxhoj me të në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar, pasi KOSTT-i ende nuk është anëtar i plotë në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit dhe Transmisionit të Energjisë Elektrike.

Rrjeti i KOSTT-it në nivel rajonal dhe ndërkombëtar prezantohet nga Sistemi i Transmisionit të Serbisë, i cili përfiton në emër të këtij rrjeti nga transitet e energjisë nëpër Rrjetin e KOSTT dhe të hyrat që krijohen nga alokimi i kapaciteteve.

IV. Raportimi i jashtëm

IV.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat ligjore mbi raportimin e NP-ve, sipas SNRF, në bazë të licencave për operim dhe sipas marrëveshjes për monitorim ndërmjet KOSTT dhe MEF, KOSTT-i duhet të raportoj si në vijim:

- Raporte tremujore dhe Raportin vjetor të Ndërmarrjes për aksionarin (MEF-in);
- Pasqyrat financiare vjetore;
- Raporte tremujore dhe vjetore për ZRrE-në. Këto raporte përgatiten në bazë të licencave që ZRrE-ja i ka lëshuar KOSTT-it për zhvillimin e afarizmit të tij; dhe
- Raporte tremujore dhe vjetore mbi Subvencionet, në bazë të marrëveshjes për Monitorim dhe Kontroll (MEF-KOSTT).

Ne kemi vërejtur edhe disa dobësi gjatë raportimit të jashtëm siç janë:

- Raporti vjetor i KOSTT-it nuk ishte përgatitur dhe miratuar nga Bordi brenda kornizës kohore sipas ligjit të NP-ve; dhe
- Raportet tremujore të dorëzuara në MEF lidhur me Subvencionet, nuk ishin të nënshkruara nga zyrtarët përkatës sipas marrëveshjes për Monitorim dhe Kontroll ndërmjet MEF-KOSTT.

Konkluzioni

Mungesa e raportimit me kohë dhe mungesa e nënshkrimit të tyre nga personat përgjegjës tregon nivelin jo të duhur të kontroleve lidhur me raportimet. Kjo mund të ndikoj në besueshmërinë e raporteve.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Bordin e KOSTT-it të siguroj që:

- Raporti vjetor të përgatitet e miratohet me kohë nga Bordi, dhe sipas kërkesave nga ligji i NP-ve të dorëzohet në MEF; dhe
- Raportimet e rregullta për subvencionet të jenë të përgatitura në përputhje me marrëveshjen për monitorim dhe kontroll dhe të nënshkruhen nga personat përgjegjës.

IV.2 Cilësia e informatave

KOSTT-i ka të pazgjidhur çështjen e rrjetit të vet në nivel të tregut rajonal dhe ndërkombëtar, pasi që Serbia prezantohet pronare e këtij rrjeti (transmisioni). Për këtë arsye sistemi i transmisionit të Serbisë përfiton në emër të KOSTT-it.

Këto çështje nuk janë trajtuar në përputhje me SNK në raportet dhe pasqyrat financiare të KOSTT-it.

Pasaktësitë në vijim nuk janë korigjuar nga ana e Menaxhmentit dhe për këtë ne po i raportojmë ato:

- Të hyrat nga tranziti i energjisë nëpër territorin e Kosovës nëpërmjet rrjetit të KOSTT-it, nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare. Kjo vlerë financiare vetëm është shpalosur në pasqyrën e shpalosjeve. Bazuar në matjet dhe faturimet e KOSTT-it vlera e të hyrave nga transiti për vitin 2010 janë llogaritur të jenë 1,464,540€ Ndërsa nga viti 2004 deri në vitin 2010 kjo vlerë ka arritur në 10,016,561€ dhe
- Shpenzimet e paraqitura në pasqyrat financiare në emër të Rregullimit sekondar për vitin 2010 janë 1,600,000€ Lidhur me këtë shpenzim KOSTT-i nuk ka dokument burimor lidhur me matjen dhe vlerën e tyre. Mirëpo kjo vlerë e paraqitur është e bazuar në kalkulimet e viteve të mëhershme. Vlera totale për këtë shërbim nga viti 2007 ka arritur në 4,214,673€

Këto janë shpenzime të aprovuara nga ZRRrE-ja. KOSTT-i në emër të këtij shërbimi ka inkasuar dhe ka akumuluar mjete nga tarifat e energjisë.

Të dy këto kategori i takojnë një çështje të pazgjidhur ndërshtetërore (Kosovës dhe Serbisë).

Këto dy kategori në raportet financiare të KOSTT-it nuk trajtohen si duhet. Derisa të hyrat nga transiti edhe pse kanë më shumë elemente për njohje, vetëm janë shpalosur. Ndërsa Rregullimi sekondar është paraqitur si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave, i cili shpenzim kishte ndikim në rezultatin financiar të Ndërmarrjes.

Konkluzioni

Trajtimi jo i duhur në lidhje me të hyrat nga tranziti dhe shpenzimet për rregullimin sekondar paraqesin një pasqyrim jo të drejtë të gjendjes financiare në raportet e KOSTT-it.

Po ashtu kjo paraqitje mund të ketë ndikim në ngritjen e dyfishtë të tarifave vjetore (çmimin e energjisë elektrike) më rastin e përcaktimit të tyre nga ZRRrE-ja.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Bordin e KOSTT-it të siguroj:

- Regjistrim të drejtë të kategorive financiare (të hyrave dhe shpenzimeve) dhe trajtim të duhur me rastin e përgatitjes së buxhetit dhe raportimit financiar; dhe
- Regjistrimet të jenë të bazuara dhe në harmoni me SNK dhe SNRF.

V. Realizimi i Buxhetit

V.1 Të hyrat

Të hyrat në KOSTT krijohen nga shërbimet e bartjes së energjisë në tensionin e lartë, mirëmbajtjes së transmisionit dhe nga menaxhimi me tregtimin e energjisë elektrike për territorin e Kosovës. Për këto shërbime KOSTT-i planifikon buxhetin dhe e dorëzon në ZRrE për aprovim. Pasi ZRrE-ja është autoriteti i cili përcakton çmimin e energjisë elektrike në Kosovë. Në çmimin (koston) e energjisë elektrike hynë edhe shpenzimet për KOSTT-in.

Të hyrat për KOSTT-in, nga konsumatorët inkasohen prej KEK-ut nëpërmjet faturave të energjisë elektrike, të cilat pastaj transferohen në KOSTT.

Për vitin 2010 KOSTT ka planifikuar të hyra nga tarifat e aprovuara nga ZRrE-ja 18,309,870€ Të hyrat e realizuara nga tarifat për vitin financiar 2010 janë në total 20,075,725€ të realizuara nga tre operatorët:

Nr. ren	Përshkrimi	Vlera €
1	Të hyrat nga Operatori i Transmisionit	10,433,869
2	Të hyrat nga Operatori i Sistemit	9,440,773
3	Të hyrat nga Operatori i Tregut	201,083
TOTAL		20,075,725

Përveç këtyre KOSTT-i gjatë vitit 2010 ka realizuar edhe të hyra tjera operative: të hyra nga interesi i parave në bankë 301,000€ të hyra tjera në vlerë prej 523,136€ dhe të hyra nga grantet e shtyra në vlerë prej 1,824,864€

Të hyrat e realizuara nga tarifat ishin për 1,766,120€ më të larta se sa planifikimi, për arsye të rritjes së transmetimit dhe faturimit të energjisë. Ndërsa të hyrat tjera operative dhe nga interesi nuk ishin paraqitur fare në planifikim, prandaj janë realizuar më shumë të hyra për 2,649,000€

Mungesa e përfshirjes së të hyrave tjera në planifikimin buxhetor paraqet një pamje jo të plotë buxhetore dhe mund të ketë ndikim në nivelin e buxhetit vjetor për KOSTT-in.

Konkluzioni

Mungesa e informatave të mjaftueshme lidhur me burimet e të hyrave të KOSTT-it në fazën e planifikimit të procesit buxhetor, është paraqitje jo e drejtë dhe e mangëte cila e dobëson procesin e buxhetimit dhe e rrezikon përcaktimin e tarifave (çmimit) të drejta.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Bordin e KOSTT-it që të siguroj:

- Planifikim adekuat të buxhetit vjetor financiar duke dhënë informatat e plota me rastin e planifikimit buxhetor dhe aplikimit për përcaktimin e tarifave.

1.1 Granti i qeverisë

Për vitin 2010 KOSTT- kishte përfituar grante nga qeveria në vlerë prej 8,628,012€ Të gjitha këto mjete ishin ndarë për projekte kapitale të cilat kishin filluar në vitet paraprake dhe ishin duke vazhduar në 2010. Ndërsa realizimi ishte në vlerën prej 8,341,684€ Regjistrimi dhe njohja e tyre në regjistrat e kontabilitetit të organizatës është bërë sipas parimit akrual të kontabilitetit.

KOSTT-i në bazë të marrëveshjes me MEF-in, kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte tre mujore për MEF-in lidhur me shpenzimet dhe progresin e subvencionit respektivisht projekteve të financuara nga MEF-i.

Dobësitë lidhur me raportimet ndaj MEF-it i kemi paraqitur në kapitullin më lartë “Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm”.

V.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimit

Procedurat e prokurimit për vitin 2010 janë në vlerë prej 3,262,341€ Përveç këtyre nga zyra e prokurimit janë shpenzuar edhe 44,656€për blerjet me vlerë minimale.

Ne kemi ekzaminuar 8 mostra, në vlerë prej 2,019,883€ apo rreth 62% e totalit të shpenzimeve të kontraktuara nëpërmjet procedurave të prokurimit.

Ekzaminimet tona kanë rezultuar më disa dobësi të cilat i kemi paraqitur në vijim:

Mungesa e të dhënave të plota në planifikimin e prokurimit

Në planifikimin përfundimtar të prokurimit nuk ka informata të mjaftueshme lidhur me kohën e fillimit të procedurave për kontratat e planifikuara. Këto informata kërkohen në formën standarde të dokumentit për planifikimin e prokurimit.

Dobësi në procesin e vlerësimit të ofertave

Testimet tona tregojnë dobësi të theksuara për procesin e vlerësimit të ofertave në KOSTT, e në disa raste vlerësimi nuk është i drejtë. Në tri procese të prokurimit ofertat nuk ishin vlerësuar si duhet, përkatësisht nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit gjatë përzgjedhjes së fituesve.

Në kontratën “Mirëmbajtja e CAS-it” dhe “Renovimi i nivelit 1 SCADA-EMS”, fituesit e tenderit nuk i kishin plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit. Ndërsa në rastin “Kontrolli sistematik i punëtorëve”, dosja e tenderit nuk ishte plotësuar dhe vulosur si duhet nga njëri ofertues.

Në këto raste kishin fituar operatorët me çmimin më të ulët ofertues, por dobësitë e identifikuara paraqesin ndikim negativ gjatë procesit të vlerësimit dhe ato duhet eliminuar.

Kontratat nuk realizohen në afatet e përcaktuara kohore

Nuk ka një harmonizim të duhur lidhur me nënshkrimin e kontratave me operatorët ekonomik dhe krijimit të kushteve nga ana e KOSTT-it, lidhur me fillimin e punëve. Në anën tjetër operatorët nuk i kanë kryer punët sipas planit dinamik të përcaktuar. Si rrjedhojë ne kemi vërejtur vonesa të mëdha në realizimin e projekteve dhe zbatim jo i plotë i kushteve të kontratës.

Në projektin “Renovimi i nivelit 1–SCADA-EMS” realizimi i kontratës është vonuar rreth 150 ditë kalendarike.

Punëdhënësi (KOSTT) ishte vonuar rreth 70 ditë kalendarike për krijimin e kushteve për fillimin e punëve. Ndërsa në anën tjetër operatori ekonomik pas fillimit të punëve është vonuar për rreth 80 ditë kalendarike në realizimin e punëve në krahasim me planin dinamik. Në këtë kontratë nuk janë aplikuar ndëshkimet e parapara për vonesa nga asnjëra palë kontraktuese.

Në rastin tjetër, kontrata për “Renovimin e Garazhes”, në vlerë 116,286€ është lidhur më 01.10.2010, ndërsa punët nuk kishin filluar ende (deri në kohën kur ne ishim në teren 01.04.2011), apo mbi 6 muaj vonesë. Arsyeja e vonesës ishte nga mungesa e krijimit të kushteve për fillimin e punëve nga punëdhënësi.

Ndërsa në kontratë parashihet që nëse punëdhënësi nuk krijon kushte të punës me kohë, mund të ndëshkohet nga operatori ekonomik.

Zyrtarët e KOSTT-it kanë dhënë arsyet e tyre rreth vonesave në projekte, mirëpo kjo nuk e arsyeton KOSTT-in për mos-harmonizim dhe planifikim jo të mirë të punëve.

Çmimi i kontraktuar përmes prokurimit ishte dukshëm më i lartë se sa çmimet e tregut

Në kontratën “Furnizim me dosje për punonjësit e KOSTT-it” në vlerë prej 2,641€ çmimi për njësi/dosje i ofertuar nga firma fituese “ACE OFFICE” është 7.59€(pa TVSH). Mirëpo

në treg çmimi për këtë produkt është dukshëm më i ulët (rreth 50%). Kjo kontratë ishte realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit për kuotimin e çmimeve.

Më këtë rast KOSTT-i nuk i kishte hulumtuar sa duhet çmimet e tregut. Në raste të tilla duhet të bëhen më shumë hulumtime rreth çmimeve në treg në mënyrë që buxheti të shpenzohet në mënyrë racionale.

Konkluzioni

Menaxhimi i blerjeve nëpërmjet prokurimit ka dobësi dhe nuk ishte bërë në përputhje të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore.

Vonesat në realizimin e kontratave tregojnë për menaxhim jo të mirë të cilat mund të kenë efekte buxhetore. Përveç këtyre KOSTT-i nuk e kishte arritur efektin themelor të legjislacionit të prokurimit mbi shpenzimin racional të mjeteve financiare.

Rekomandim 4

Rekomandojmë Bordin e KOSTT-it të siguroj:

- Të dhëna të mjaftueshme gjatë përgatitjes së planifikimit të prokurimit lidhur me kohën e planifikuar të kontraktiveve;
- Vlerësim të drejtë të ofertave në përputhje të plotë me qëllimet e legjislacionit në fuqi; dhe
- Të harmonizohet koha e lidhjes së kontratave me fillimin e punëve dhe të respektohen të gjitha kushtet e kontratës.

2.2 Blerjet tjera

Prej shpenzimeve tjera të realizuara nga KOSTT-i gjatë vitit 2010 ne kemi testuar shpenzimet për Riparim dhe Mirëmbajtje dhe Shpenzimet tjera operative. Secila nga këto kategori ka edhe nën kategoritë e veta të shpenzimeve. Vlera financiare e këtyre shpenzimeve në pasqyrat financiare është 1,711,336€ Prej tyre ne kemi testuar 496,267€ apo 29% e totalit të tyre.

Ne i kemi identifikuar disa dobësi të cilat i kemi paraqitur në vijim.

Menaxhim jo i mirë i procesit të shpenzimeve për riparimin e automjeteve

Në shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve kemi vërejtur se është bërë faturimi ndryshe nga çmimet e specifikuar në kontratë si dhe kemi identifikuar një rast kur është dyfishuar shërbimi i kryer.

Tejkalime mujore dhe vjetore të shpenzimeve të reprezentacionit

Bordi i KOSTT-it ka nxjerrë një vendim lidhur me shpenzimet e reprezentacionit. Për qëllime të kontrollit për këto shpenzime janë caktuar zyrtarët të cilët kanë të drejtë shfrytëzimi dhe është definuar shuma mujore për shpenzim të reprezentacionit.

Mirëpo ky vendim nuk ishte respektuar dhe kishte raste kur shpenzimet kishin tejkaluar vlerën e lejuar. Vlera e tejkaluar vjetore në dy mostrat tona ishte 1,743€

KOSTT-i ka paraqitur faktin se shpenzimet e reprezentacionit në nivel të KOSTT-it nuk janë tejkaluar, por kjo nuk i arsyeton tejkalimet individuale dhe nuk është në harmoni me vendimin për shpenzimet e reprezentacionit.

Konkluzioni

Mungesa e funksionimit të kontroleve në lidhje me këto shpenzime ka ndikuar në menaxhimin jo të mirë, rrjedhimisht të ndodhin parregullsitë dhe gabimet e paraqitura.

Më përjashtim të këtyre mangësive, në menaxhimin e këtyre shpenzimeve nuk kishte ndonjë parregullsi në aspektin material.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Bordin e KOSTT-it të siguroj:

- Kontrole adekuate në menaxhimin e shpenzimeve për riparim dhe mirëmbajtje;
- Se një qasje e matur është nxitur lidhur me reprezentacionin dhe janë implementuar vendimet e marra.

2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Në KOSTT gjatë vitit 2010 ishin të punësuar 213 punëtor. Shpenzimet për kompensimet e stafit (paga dhe mëditjet) për vitin 2010 janë 2,647,719€

Ne kemi testuar dhjetë mostra nga dosjet e personelit, pagesat për orët jashtë orarit dhe pagesat në bazë të vlerësimit të performancës.

Dobësitë në mirëmbajtjen e dosjeve dhe menaxhimin e këtyre shpenzimeve i kemi shpalosur në vijim.

Dosjet e personelit nuk ishin të kompletuara, si dhe nuk kishte kontroll të mirë në terminalët kohore

Në dosjet e personelit mungonin disa të dhëna personale për të punësuarin, të cilat kërkohen sipas Manualit të punëtorëve të KOSTT.

Po ashtu kemi vërejtur se mungojnë kontrollet e duhura me rastin e daljes së punëtorëve në punë jashtë orarit. Koha e punës së kryer, e shënuar në “urdhëresat” e lëshuara nga drejtorët e departamenteve nuk përputhet më kohën e evidentuar në терминаlet kohore.

Kjo për arsye se punëtorët nuk evidentohen në terminalin kohor në përputhje me urdhëresat, andaj orët e punës jashtë orarit nuk janë të matura si duhet.

Ndërsa kompensimet për punë jashtë orarit bazohen vetëm në urdhëresë dhe nuk bazohen në evidencat e terminalit kohor, i cili dokumenton prezencën e punëtorëve.

Nuk është bërë vlerësim vjetor për stafin jo-menaxhues,

Për vitin 2010 KOSTT-i nuk ka bërë vlerësimin e performancës për punëtorët e saj, por vlerësimi është bërë vetëm për stafin menaxherial, në bazë të të cilit vlerësim është paguar performanca e tyre. KOSTT-it po ashtu i mungojnë politikat apo rregulloret e brendshme lidhur me vlerësimin vjetor të stafit jo menaxherial.

Konkluzioni

Përkrahja e Burimeve Njerëzore duhet të forcohet që të sigurohet transparencë, drejtësi dhe zhvillim të personelit.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Bordin e KOSTT-it që të siguroj:

- Dosjet e personelit të azhurnohen dhe kompletohen me të dhëna sipas Manualit;
- Të ngritët kontrolli në terminalin kohor rrjedhimisht në urdhëresat për punë jashtë orarit; dhe
- Të hartohen rregullore apo politika për vlerësimin vjetor për tërë stafin e Ndërmarrjes.

VI. Kontrolli mbi menaxhimin

VI.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo organizatë në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike, duke siguruar raportim të besueshëm financiar.

Të gjeturat tona kanë treguar se KOSTT ka nevojë të përmirësoj dhe të vendosë kontrolle më të mira në Ndërmarrje.

Dobësitë kryesore që i kemi identifikuar gjatë auditimit tonë janë:

- Mungesa e raportimit me kohë dhe aprovimit të tyre nga personat përgjegjës;
- Dobësitë e vërejtura në menaxhimin e blerjeve nëpërmjet procedurave të prokurimit;
- Mungesa e kontrolleve në menaxhimin e reprezentacionit dhe shpenzimeve për riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve;
- Kontrolli jo i mirë në klasifikimin e investimeve nga shpenzimet; dhe
- Mungesë e vlerësimit vjetor për stafin jo menaxherial dhe kontrollet jo të mira mbi termialet kohore dhe urdhëresat e punës.

Konkluzioni

Ne konkludojmë se dobësitë e lartcekura rrjedhin nga mangësitë në dizajnin dhe implementimin e kontrolleve të brendshme në KOSTT.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Bordin e KOSTT-it të siguroj që Drejtori:

- Të analizoj në përgjithësi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të forcoj edhe më tutje kontrollet në fushat në të cilat janë identifikuar dobësitë.

VI.2 Auditimi i Brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë dhe drejtuesit e Ndërmarrjes se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

KOSTT-i ka të formuar zyrën e Auditimit të Brendshëm e cila udhëhiqet nga Zyrtari i Auditimit. Zyrtari i Auditimit për punën e tij raporton tek Komisioni i Auditimit i cili e aprovon planin vjetor të tij.

Zyrtari i Auditimit të brendshëm gjatë vitit 2010 kishte kryer tetë raporte të auditimit. Auditimi i brendshëm ka mbuluar fushat: Burimet Njerëzore, Financat, Prokurimin, Sektorin Teknik-Menaxhimi i mjeteve themelore, Autoparkun dhe Depon si dhe tri auditime të veçanta për tri Projekte Kapitale.

Raportet e AB i kemi vlerësuar si cilësore të cilat në vete përmbanin në detaje të gjeturat, ndikimet e tyre, si dhe rekomandimet se si Menaxhmenti përgjegjës të përmirësoj menaxhimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Konkluzioni

Në takimet e rregullta të Komisionit të auditimit diskutimet rreth raporteve të AB nuk ishin të mjaftueshme. Raportet e AB janë mekanizëm që sigurojnë kualitetin e sistemit të kontrolleve të brendshme të vendosura dhe mangësitë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Bordin e KOSTT-it që të sigurojnë:

- Se Auditimi i Brendshëm funksionon, gjithashtu edhe Komiteti i Auditimit kryen punën si duhet; dhe
- Menaxhmenti të siguroj veprime lidhur me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

VII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e KOSTT

Ne konkludojmë se KOSTT-i përkundër vështirësive që ka me statusin e rrjetit të saj në nivel rajonal, ka arritur që brenda saj të vendos një sistem të kontrollit të brendshëm, për menaxhim të duhur.

Megjithatë auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Prezenca e tyre në vazhdimësi, mund të zbehtë besueshmërinë ndaj menaxhimit dhe kontrolleve në KOSTT.

Mangësitë janë vërejtur sidomos në raportimet me kohë, menaxhimin e blerjeve nëpërmjet prokurimit, realizimin e kontratave si dhe në menaxhimin e personelit. Po ashtu trajtimi i të hyrave nga transiti dhe shpenzimet e rregullimit sekondar janë çështje që duhet përmirësuar.

Kjo na shpjen në mendimin se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke siguruar menaxhim cilësor.

Rekomandimi i përgjithshëm

- Bordi duhet të sigurohet nga menaxhmenti, që në ndërmarrje funksionojnë kontrollet adekuate mbi realizimin e shpenzimeve dhe raportimin e tyre; dhe
- Bordi duhet të siguroj zhvillimin e instruksioneve dhe procedurave të qarta, të cilat do të ndihmojnë adresimin e dobësive të kontrollit dhe mangësive të adresuara në këtë raport.

Shtojca I. Komentet e KOSTT-it dhe përgjigjja e ZAP-it

Menaxhmentit të KOSTT-it i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij Raporti. Menaxhmenti ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në Raportin e auditimit për menaxhimin financiar dhe kontrollet në KOSTT për vitin 2010 dhe nuk ka dhënë ndonjë koment.

Më tutje, ata janë zotuar se do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.